

ALBANIAN PREPOSITION /ME/ AND ITS EQUIVALENTS IN THE FRENCH LANGUAGE

PARAFJALE SHQIPE /ME/ DHE EKVIVALENTËT E SAJ NË GJUHËN FRËNGE

Shejnaze AJDINI-MURTEZI¹, Dëfrim SALIU²

^{1*} *Institute of Spiritual and Cultural Heritage of the Albanians – Skopje*

² *Department of French Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

^{*}*Corresponding author e-mail: sheajdini@hotmail.com*

Abstract

The use of prepositions is one of the most challenging aspects of grammar in any language. Translating them poses much greater difficulty than translating other parts of speech such as nouns, pronouns, verbs, etc., so often the sentence structure needs to be entirely changed to accurately translate a specific preposition. Given the reality that studies on Albanian prepositions, especially from a contrastive perspective, are not plentiful, we have decided to dedicate this work to the study of Albanian prepositions to highlight their semantic characteristics, examining their uses and meanings, and comparing Albanian structures containing these prepositions with their equivalents in French. Therefore, the primary focus of this research is to identify equivalence and understand the syntactic differences that may exist between these two languages.

Keywords: preposition, meaning, equivalents, Albanian language, French language.

Përmbledhje

Përdorimi i parafjalëve është një nga pjesët më problematike të gramatikës së çdo gjuhe. Përkthimi i tyre paraqet shumë më shumë vështirësi se sa përkthimi i pjesëve të tjera të ligjëratës, si i emrave, i mbiemrave, i foljeve etj., kështu që ka raste të tilla kur duhet ndryshuar e tërë struktura e fjalisë me qëllim që të përkthehet saktë një parafjalë e caktuar. Duke u nisur nga ky realitet dhe nga fakti se studimet në lidhje me parafjalët shqipe, sidomos në rrafshin kontrastiv nuk janë të shumta, ne jemi përcaktuar që këtë punim t'ia kushtojmë studimit të parafjalës së parme shqipe *me* me qëllim që t'i vejmë në pah karakteristikat semantike, duke i shqyrtuar përdorimet dhe kuptimet e saj të mundshme dhe duke i krahasuar strukturat shqipe që përmbajnë këtë parafjalë me ekuivalentet e tyre në gjuhën frënge. Pra, fokusi kryesor i këtij hulumtimi është gjetja e barasvlefshmërisë, por edhe ndryshimi në kuptim që mund të kenë disa ndërtime sintaksore në këto dy gjuhë.

Fjalët kyçe: parafjala me, kuptimi, ekuivalentët, gjuhë shqipe, gjuhë frënge.

1. Hyrje

Parafjalët, në përgjithësi luajnë një rol thelbësor në ndërtimin gramatikor të fjalive, për shkak se nëpërmjet tyre mundësohet shprehja e nuancave të shumta kuptimore, si edhe lidhja e elementeve të ndryshme të një fjalie, gjegjësisht krijimi i marrëdhënieve midis fjalëve dhe grupeve të fjalëve në mënyrë të saktë dhe koherente. Përdorimi i parafjalëve është një nga pjesët më të vështira të gramatikës së çdo gjuhe. Dhe, meqë sistemi i parafjalëve nuk është i njëjtë në gjuhë të ndryshme, ai mund të paraqesë më shumë vështirësi gjatë përkthimit sesa përkthimi i emrave, mbiemrave e kategorive tjera gramatikore. Pra, ndodh që duhet të ndryshojmë strukturën e tërë fjalisë vetëm për të përkthyer saktë një parafjalë të thjeshtë.

Ky është shpesh edhe njëri nga shkaqet e pengesave që hasen gjatë mësimin të një gjuhe të huaj, e në rastin tonë të gjuhës frënge. Pikërisht për këtë arsye ne do të mundohemi që në këtë punim t'ua përafrojmë këto dy sisteme të gjithë atyre që i mësojnë dhe i flasin gjuhët në fjalë. Për realizimin e këtij hulumtimi, korpusin tonë e kemi formuar nga shembuj që përmbajnë parafjalën *me*, të nxjerrë nga katër romane origjinale në gjuhën shqipe: dy romane të shkrimtarit Ismail Kadare (*Kronikë në gur* dhe *Pallati i ëndrrave*) dhe dy romane të shkrimtarit Luan Starova (*Librat e babait* dhe *Koha e dhive*), si edhe versionet e tyre të përkthyer në gjuhën frënge.

Për të qartësuar më mirë punën tonë, në fillim do t'i vejmë në pah karakteristikat semantike dhe përdorimet e parafjalës shumëkuptimëshe shqipe *me*, si edhe përdorimet e parafjalëve frënge *avec* dhe *de* me të cilat ajo është përkthyer në fjalorët dygjuhësorë e që më pastaj t'i krahasojmë strukturat, pjesë e së cilave është ajo, me strukturat e përkthyer në gjuhën frënge në mënyrë që t'i gjejmë ngjashmëritë dhe dallimet që ekzistojnë midis tyre. Shkurtesat në kllapa që pasojnë shembujt e cituar nënkuptojnë inicialet e veprës, të autorit dhe faqen prej ku është nxjerrë shembulli i caktuar.

2. Metodat

Në fillim kemi analizuar kuptimet e mundshme të parafjalës *me* dhe të atyre frënge (*avec* dhe *de*), ndërsa me ndihmën e analizës krahasuese e kontrastive kemi bërë krahasimin e fjalive që përmbajnë parafjalën *me* në gjuhën shqipe me fjalitë frënge për të parë nëse përkthimi i tyre përmban sintagma identike apo krejtësisht të ndryshme në gjuhën frënge.

3. Qasje teorike

I stërbushur me përshkrime kryesisht sintaksore, studimi i strukturës semantike të parafjalës për gjatë kohë ishte lënë mënjanë. Me zhvillimin e qasjeve konjitive, në semantikën parafjalore u shfaqën ide të reja, duke e konsideruar parafjalën si një tërësi konceptesh të cilat aktivizohen në ndërgjegjen e folësit kur ai e përdor parafjalën në ligjërimin e tij. Sipas gramatikave të ndryshme, si të gjuhës shqipe, ashtu edhe të gjuhës frënge, në përgjithësi parafjalët përcaktohen si fjalë që shërbejnë për të shprehur ose për të precizuar marrëdhëniet që kanë fjalët me njëra tjetrën.

Parafjalët shqipe ishin objekt studimi i shumë gjuhëtarëve si: A. Xhuvani (1964), M. Çeliku (1972, 1975, e 2019), E. Lafe (Kreu X i Gramatikës së Gjuhës Shqipe, I, 1976/1995), R. Përnaska (1976, 1996), M. Samara (1999), M. Karagjozi (2005), Sh. Demirajt dhe disa krerë të Gramatikës së Gjuhës Shqipe të ASh, vëllimi II, Sintaksa, 1996, hartuar nga Domi, Totoni, Çeliku. Duke qenë se numri i punimeve kushtuar parafjalës së parme shqipe *me* është mjaft i kufizuar, sidomos në rrafshin kontrastiv, ne e kemi zgjeruar fushën tonë të kërkimit duke u fokusuar në studimet e gjuhëtarëve shqiptarë, kryesisht të atyre për parafjalët e parme, bazuar në rëndësinë e rezultateve të marra dhe ndikimin që ato mund të kenë për hulumtimin tonë.

Nga punimet me vlerë të jashtëzakonshme për parafjalët e parme është ai i Aleksandër Xhuvanit.⁵² Në monografinë e tij, ai jep këtë përkufizim për parafjalën: „Parafjala është pjesë e palakueshme e ligjëratës që tregon marrëdhënie të ndryshme midis dy gjymtyrëve të fjalisë” (1985:7). Ai më tej shprehet se „vlera leksikore e parafjalëve caktohet nga brendia kuptimore e fjalëve të një konteksti të dhënë, ku gjenden ato” (1985:9). Një lidhje me këtë një përkufizim të ngjashëm e gjejmë edhe në *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II*: „Kuptimi i parafjalëve sqarohet brenda togfjalëshit dhe varet si nga kuptimi i gjymtyrës përcaktuese, para së cilës rri parafjala, ashtu dhe nga kuptimi i gjymtyrës së përcaktuar prej saj” (1976:334).

Të gjitha parafjalët e shqipes në fjalinë e thjeshtë, shprehet Memet Çeliku, vënë në lidhje gramatikore nënrenditëse fjalë emërtuese të caktuara siç janë emrat/përemrat para të cilave ato qëndrojnë, ndaj fjalëve të tjera drejtuese, kryesisht foljeve dhe emrave. Këtë rol parafjalët arrijnë ta kryejnë duke u bërë pjesë strukturore/semantike e përbërësve sintaksorë të cilat i formësojnë dhe i aftësojnë për t’u futur në lidhje nënrenditëse ndaj përbërësve kokë (Çeliku, 2019:14).

Parafjalët janë mjete gramatikore që në fjalinë e thjeshtë shprehin njëherësh raporte gramatikore dhe semantike. Karakteristikë kryesore e parafjalëve është të shprehurit e marrëdhënieve gramatikore të varësisë, si klasë e veçantë fjalësh gramatikore, ndërsa karakteristikë tjetër e tyre është të shprehurit e marrëdhënieve të ndryshme semantike. Shumëkuptimësia semantike e tyre lidhet drejtpërsëdrejti me semantikën e fjalës drejtuese e të varur, nëpërmjet strukturës morfo-sintaksore të sintagmave, sepse kuptimi leksikor i parafjalëve nuk është i plotë dhe i mëvetëshëm siç është ai i fjalëve leksikore-emërtuese, thënë ndryshe vlera e parafjalëve caktohet nga brendia kuptimore e fjalëve të një konteksti të dhënë.⁵³

Ngjashëm me këto përkufizime janë edhe ato për parafjalët e gjuhën frënge. Sipas gramatikës së gjuhës frënge *Le bon usage*: „parafjala është një fjalë e pandryshueshme që vë një lidhje nënrenditëse midis fjalëve apo sintagmave” (përkthimi ynë) (Grevisse, 1993:1476). Ndërsa nga Riegel e kemi këtë përkufizim: „Parafjala është një pjesë e pandryshueshme e ligjëratës që i përket kategorisë së përgjithshme të fjalëve lidhëse. Sikurse lidhëzat bashkërenditëse dhe nënrenditëse, ajo shërben për të lidhur fjalë (koncepte) me qëllim që t’i integrojë në një ndërtim më të gjërë” (Riegel, 2021:369).

Parafjalët shpesh pasohen nga një plotës, i cili mund të jetë një emër, përemër, grup emëror ose edhe një parafjalë tjetër. Sipas Maurice Grevisse-it, parafjalët janë „fjalët më të paqarta në gjuhë”, sepse ato mund të kenë kuptime të shumta dhe të përdoren në kontekste të ndryshme (Grevisse, 2013:11). Studimet në lidhje me parafjalët e gjuhës frënge në përgjithësi, e në veçanti për parafjalët e thjeshta, janë të shumta. Këtu mund të përmendim gjuhëtarët Pierre Cadiot (*Les prépositions abstraites en français*) 1997, Injoo Choi-Jonin (*La préposition “avec” : opérateur de (dé)composition*), 1995, Scolia, 5, Strasbourg, Université des Sciences Humaines Strasbourg 2, p. 109-129), Iva Dedková (*La préposition avec dans un corpus littéraire contemporain, Romanica Olomucensia* 28.2 (2016): 137–151 (ISSN 1803 – 4136), pdf. f. 139.) e të tjerë.

4. Vlerat semantike të parafjalës *me*

Ta kapësh kuptimin e një njësie apo shprehje gjuhësore është një punë mjaft e ndërlikuar. Në të vërtetë, fakti i nxjerrjes së një kuptimi varet nga veçoritë e ndërtimit të atij kuptimi që del nga raportet e ndërtuara ndërmjet njësive të ndryshme që e përbëjnë atë fjali, dhe jo nga vetë njësia.

⁵² Aleksandër Xhuvani, *Parafjalët*, botuar në Studime Filologjike, Tiranë, 1964.

⁵³ Shih: Memet Çeliku, *Parafjalët e shqipes standarde (Trajtim leksiko-semantik e gramatikor)*, Tiranë, 2019, f. 36; Aleksandër Xhuvani, *Parafjalët*, Studime Filologjike, Tiranë 1964, f. 3.

Në lidhje me këtë, Gustave Guillaume thotë se: „dinamika e kuptimit formon një sistem që i nënshtrohet parimeve themelore të teorisë së Gestalt-it (formës) ku tërësia është më shumë se shuma e pjesëve të saj dhe nga ana tjetër, një pjesë në një tërësi dallon nga një pjesë e veçuar apo nga një pjesë e një tërësie tjetër” (Guillaume, 1971: 23). Pra, kuptimi i një parafjale mund të interpretohet në dy mënyra: nga njëra anë, kur merret e veçuar dhe nga ana tjetër, kur është pjesë e një tërësie, ku kuptimi mund të ndryshojë nga një fjali në tjetrën në varësi të kontekstit dhe situatave të ndryshme të ligjërimitt. Në fakt, parafjala mundëson lidhjen semantike të ligjërimitt me informatat e kontekstit. (Guillaume, 1971: 92,93).

Siç e cekëm edhe në Hyrje, pikë së pari do t’i shohim dhe analizojmë vlerat e ndryshme semantike që mund të marrë parafjala *me* varësisht situatave të ndryshme të ligjërimitt. Këtu nuk duhet harruar të theksojmë se parafjala *me* si se shumica e parafjalëve të parme, kërkon rasën kallëzore. Për t’i paraqitur kuptimet e parafjalës *me* jemi bazuar kryesisht në monografinë e Aleksandër Xhuvanit (*Parafjalët*, Studime Filologjike, 1964, f. 49-53, në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe*, 1980, f. 1103-1104, monografinë e Remzi Përnaskës (*Kundrinori me parafjalë në gjuhën e sotme shqipe*, 1996, f. 94-124), në studimin e Mehmet Çelikut (*Parafjalët e shqipes standarde*, 2019, f. 104-116) etj. (Xhuvani, 1964:104,105).

Krahasimi i gramatikave, fjalorëve e monografive në fjalë bën t’i konsiderojmë si ortonimike përdorimet e mëposhtme të parafjalës *me*:

- shoqërim, bashkim, lidhje, përcjellje;
- tipar, cilësi të një personi, sendi a veprimi (emër + me + emër në kallëzore të pashquar);
- mënyrën si kryhet a shfaqet veprimi i foljes (kuptim i drejtpërdrejtë a i figurshëm);
- mjetin me të cilin kryhet një veprim;
- lëndën me të cilën është ndërtuar ose është zbukuruar një send;
- parafjala *me*, gjithashtu mund të formojë edhe lokucione ndajfoljore kohe (me kohë, me natë) mënyre (me vrap, me nxitim);
- parafjala *me*, përdoret edhe për të formuar shprehje frazeologjike: me zemër në dorë, ndjek me sy, marr me mend);
- parafjala *me*, përveç nuancave kryesore, përdoret shpesh edhe për të shprehur nuanca të lidhjes, kufizimit, llojit, përqasjes etj.;
- marrëdhënie kohore paskohësie.

Meqë në fjalorët dygjuhësorë e në gramatika të ndryshme, siç është ajo e Henri Boisson (1975:202). parafjala *me* në gjuhën frënge është përkthyer me *avec* dhe *de*, ne e kemi parë të nevojshme t’i shohim edhe kuptimet dhe përdorimet e tyre, duke u bazuar në disa gramatika frënge, si atë të Grevisse-it (gamma, pdf. 727), të Riegel-it dhe të tjerëve (online, pdf. 642-644), si edhe studimin e Cadiot-s (1997:141-149). Parafjala *avec* klasifikohet në grupin e parafjalëve mikste, të vendosura midis të ashtuquajturave me ngjyrë (colores) dhe pa ngjyrë (incolores). Dy nga vlerat e saj, e shoqërimit dhe e mjetit, shpesh janë konsideruar si prototipike sipas kuptimit të tyre.⁵⁴

Parafjala *avec* tregon:

- shoqërim, bashkim, lidhje;
 - mjetin me të cilin kryhet veprimi;
 - mënyrën si kryhet a shfaqet veprimi i foljes;
 - lëndën me të cilën është ndërtuar ose është bërë diçka;
 - posedim.
- Parafjala *de* tregon:
- prejardhje;
 - kohë;
 - lëndën me të cilën është ndërtuar ose është bërë diçka;

⁵⁴ Shih: Cadiot 1997:36 apo Choi-Jonin 2006:3.

- shkak;
- raport të brendësisë së enës me përmbajtjen;
- cilësi dhe vlerësim sasior.

Në bazë të dhënave teorike të mësipërme, mund të konstatojmë se parafjala *me* me *avec* ndajnë një numër të caktuar të përdorimeve, si shoqërimin, lidhjen me të tjerët, mjetin, lëndën, mënyrën, kurse me parafjalën *de* përputhet në këto përdorime: lëndën, mjetin, cilësinë, shkakun etj., por megjithatë, siç do të shohim edhe nga shembujt e korpusit tonë, në shumë raste parafjala *me* nuk mund të përkthehet me *avec* apo me *de*.

Pra mësimi dhe përkthimi i parafjalëve shpesh është i vështirë, për shkak se çdo gjuhë ka sistemin e vet kompleks dhe rregullat e veta të përdorimit të parafjalëve. Nga kjo rezulton se edhe parafjala *me* nuk mund të përkthehet çdoherë me parafjalë frënge, por duhet kërkuar edhe mundësi tjera. Kështu që si ekuivalentë të saj nuk do të konsiderohen vetëm parafjalët frënge, por edhe fjalët dhe shprehjet tjera me të cilat ajo është përkthyer në romanet prej ku janë nxjerrë shembujt e korpusit tonë.

Analiza e korpusit

Përkthimi i parafjalës *me*:

I. *avec*

1. ...merrnim **me vete** vazhdimisht orën e vjetër me lavjerrës të familjes, ... (L.B., L.S.:87)
 - ...nous avons constamment emporté **avec nous** la vieille horloge à balancier de la famille, ... (L.P., L.S.:81).

2. S'kishin sjellë gjë **me vete** pos më të domosdoshmeve, por secili kishte marrë çelësat e shtëpisë në të cilën me siguri, nuk do të kthehej kurrë. (K.Dh., L.S.:18).

- Ils n'avaient emporté **avec eux** que le strict nécessaire, mais chacun avait pris avec soi les clefs du logis dans lequel est pourtant assuré de ne jamais retourner. (L. Ch., L.S.:13).

3. Si ta përthithte energjinë që lirohej prej ëndrrave tona, ai zhytej në një lexim të ri, **me një vëmendje** më të përqendruar, ... (L.B., L.S.:40) - mënyrën se si kryhet veprimi.

- Mon père semblait alors absorber l'énergie qui se libérait de nos songes pour replonger dans ses lectures **avec une attention** plus soutenue, ... (L.P., L.S.:20).

4. Kur ndërmjet qytetit tonë dhe Stambollit u vendos edhe lidhja e rregullt me autobus, ne, gjithnjë e **me më pak durim** e prisnim çastin që ta përcillnim babanë, sa pa e lënë forcat, ... (L.B., L.S.:242) - mënyrën se si kryhet veprimi.

- Quand une liaison régulière par autocar fut rétablie entre notre ville et Istanbul, **c'est avec une impatience grandissante** que nous guettâmes l'heure où nous pourrions accompagner, tant qu'il en aurait encore la force, ... (L.P., L.S.:264).

5. Atje, në sternën e errët e të shurdhër, ato do të kujtonin pastaj **me pikëllim** hapësirat qiellore, që nuk do t'i shihnin më kurrë, ... (K.G., I.K.:15) - mënyrën se si kryhet veprimi.

- Dans le réservoir sombre et sourd, elles devaient évoquer **avec une morne tristesse** les espaces célestes qu'elles ne reverraient jamais plus, ... (Ch. P., I.K.:9).

6. Këta barbarë **me pupla në kokë** janë gati të ringjallin edhe doket e mesjetës, ... (I.K.:51).

- « Ces barbares, **avec leurs plumes sur la tête**, sont prêts à ressusciter les coutumes médiévales »... (I.K.:21) - tipar.

7. I tmerruar deshi ta mbyllte përsëri, madje zgjati krahun për ta kapur flegren që vazhdonte të hapej ende **me një kuisje vajtuese**, ... (P.Ë., I.K.:39).

- Terrifiée, il ébaucha le geste de la refermer, tendit même le bras pour agripper le battant qui continuait de tourner sur ses gonds **avec un grincement**. (P.R., I.K.:13).

8. *Nuk thonë kot, qeveria e zë lepurin me qerre.* (P.R., I.K.:140) - mënyrën se si kryhet veprimi.

- *Le gouvernement est capable d'attraper le lièvre avec un char à boeufs!* (P.Ë., I.K.:104).

Nga analiza e përkthimit të fjalive në pjesën I, mund të themi se përdorimet, kuptimet dhe strukturat frënge pothuajse përputhen plotësisht me ato shqipe, me përjashtime të vogla. Në I. (1, 2) ku tregohet lidhje veprim-objekt, sintagma në gjuhën shqipe është: P + përemër vetvetor, ndërsa në gjuhën frënge është P + përemër vetor (tonique), porse kuptimi është i njëjtë. Në I.3 ku tregohet mënyra se si kryhet veprimi, kemi përputhshmëri të plotë të sintagmave në të dy gjuhët (P + emër), ndërsa në I.4 kemi struktura të ndryshme.

Në I.5 në gjuhën shqipe kemi sintagmën P + emër, ndërsa në gjuhën frënge kemi P + nyje e pashquar + mbiemër + emër, edhe pse e njëjta mund të përkthehet: *avec tristesse* (P + Ø emër) nga fakti se në një sintagmë emërore *avec* mund të përdoret pa përcaktorë (sans déterminant : *avec impatience, avec terrasses*)⁵⁵, njësoj si sintagma e gjuhës shqipe, po padyshim këtu vjen në shprehje qëndrimi i përkthyesit për t'i dhënë më shumë stil fjalisë. Në I.6 ku tregohet tipar, kemi struktura të njëjta, derisa në I. (7, 8), ku shprehet mënyra e veprimit, në gjuhën shqipe janë përdorur shprehje me kuptim figurativ të cilat janë përkthyer me përshtatje në gjuhën frënge.

II. *de*

1. *Po ai gjithmonë ishte i mbyllur me bravë dhe me dry të posaçëm.* (L.B., L.S.:41).

- *Oui, il demeurait toujours fermé avec soin, tant au moyen d'une serrure que d'un cadenas particulier.* (L.P., L.S.:21).

2. *Çdo pëllëmbë e shtëpisë, edhe ashtu e tej ngarkuar me praninë tonë, ishte e mbushur me sende të ndryshme.* (L.B., L.S.:16) - lëndën me të cilën është ndërtuar ose është mbushur një send.

- *Aussi n'y avait-il un empan qui ne fut encombré d'objets dans cette demeure débordant déjà de notre présence.* (L.P., L.S.:13).

3. *Në fund u bë e qartë se mund ta shpëtonte vetëm një oftalmolog me famë botërore në Paris.* (L.B., L.S.:91) - cilësi.

- *À la fin, il devint évident que seul un ophtalmologue de renommée mondiale, qui vivait à Paris, serait capable de lui épargner la cécité.* (L.P., L.S.:86).

4. *Të lexuar apo të palexuar deri në fund, të përkthyer ose jo, por me një kuptim të shtrirë në kohë.* (L.B., L.S.:253) - cilësi.

- *Lus tout à fait ou pas complètement, traduits ou pas, mais néanmoins tout chargés d'une signification étalée dans le temps.* (L.P., L.S.:279).

5. *Të bardha si vetë bora, me sytë që u shkëlqenin si shumë diej të vegjël, ato ngrohnin fëmijërinë tonë.* (K.Dh., L.S.:144) - cilësi.

- *Aussi blanches que la neige, elles avaient des yeux brillants comme autant de petits soleils qui réchauffaient notre enfance.* (L. Ch., L.S.:178).

Parafjala *me*, siç e cekëm edhe më lart, në fjalorët dygjuhësorë përkthehet edhe parafjalën *de*. Përkthimi me parafjalën *de* në rastin II.1 ku shprehet mjet, është i patjetërsueshëm, për shkak se përdorimi i një kundrinori të drejtë të dytë me parafjalën *avec* e vështirëson të kuptuarit. Siç mund të vërehet nga shembulli II.1. sintagmat dhe kuptimet përputhen në të dy gjuhët.

⁵⁵ Shih: Iva Dedková, *La préposition avec dans un corpus littéraire contemporain*, Romanica Olomucensia 28.2 (2016): 137–151 (ISSN 1803 – 4136), pdf. f. 139.

Si parafjala *me* ashtu edhe parafjala *de* përdoren për të shprehur një sasi të përafërt apo të pacaktuar të një lënde me të cilën është ndërtuar ose është mbushur një send. Në këtë rast ajo përdoret pa nyje të pashquar, siç është rasti edhe me shembullin II.2. Pra si në shqip, ashtu edhe në frëngjisht sintagmat përputhen: P + emër. Në shembujt II. (3, 4), ku tregohet cilësi, si sintagmat ashtu edhe kuptimet përputhen plotësisht. Në II.3 kemi: P + emër + mbiemër, kurse në II.4 kemi: P + nyje e pashquar + emër.

III. en

1. *Këto dallime, këto tekste të shkruara me alfabetë të ndryshme, filluan të linin gjurmë të pashlyeshme tek unë,....*(L.B., L.S.:13)

- *Ces différences, ces textes écrits en alphabets dissemblables commencèrent donc à me marquer, à s'imprimer en moi....*(L.P., L.S.:16)

2. *Kurrë nuk kishte parë aq shumë njerëz me uniformë,....*(K. Dh., L.S.:176)

- *Elle n'avait jamais vu autant d'hommes en uniforme,....*(L. Ch., L.S.:221)

IV. à

1. *Ndërkaq, nëna ndezi llambën me vajguri dhe bashkë me babanë e me gjyshen zbriti shkallët.* (K.G., I.K.:17)

- *Mamam alluma la lampe à pétrole et, précédant papa et grand-mère, descendit l'escalier.* (K.P., I.K.:11)

2. *Bufetierët e paktë, me fytyra të vrara, një pjesë e tryezave të hequra mënjanë për të bërë pastrim, të gjitha këto të bënin shpirtin vrer.* (P.Ë., I.K.:125) – tipar.

- *Les rares serveurs aux traits tirés de fatigue, les tables en partie repoussées afin de permettre de balayer la salle, tout dégageait une certaine mélancolie.* (P.R., I.K.: 90)

Parafjal *me* siç vërehet edhe nga shembujt e mësipërm, është përkthyer edhe me parafjalën *en* dhe *à*. Në të dy shembujt III.(1, 2) ku tregohet lënda parafjala *en* gjendet në përbërje të njëjtë, sikurse edhe parafjala *me*: 1. P + emër + mbiemër; 2. P + emër. Edhe në IV.(1, 2), parafjala *à* gjendet në përbërje sintaksore identike me parafjalën *me*.

V. me fjalë të tjera

1. U ngrita, hodha rizën në kokë e *me vrap* te Mane Vocoja. (I.K.:24)

- *...je me suis levée, j'ai jeté mon fichu sur ma tête, et j'ai couru chez Mane.* (I.K.:21)

2. *Si çdo njeri që kapërcente për herë të parë portën e një zyre të rëndësishme qeveritare, e aq më tepër që vinte me zemër të ngrirë, ...*(P.Ë., I.K.:38) - mënyrën e veprimit.

- *Comme quiconque franchit pour la première fois le seul d'une administration importante, et d'autant plus qu'il était venu là le cœur glacé d'incertitude, ...*(P.R., I.K.:12).

3. *Spastrimi i parë i vërtetë fillon këtu. Ashtu siç ndahet gruri nga egjra, ashtu ndahen këtu ëndrrat me vlerë nga ato pa vlerë.* (P.Ë., I.K.: 54).

- *La véritable sélection commence ici. Comme on sépare le bon grain de l'ivraie, ainsi sont ici séparés les rêves qui présentent de l'intérêt de ce qui n'en présentent aucun.* (P.R., I.K.:25)

4. *Pa shih, pa shih, na paska hyrë në Tabir Saraj njëfarë Mark-Alemi, një zog me pupla, i cili, qysh në ëndrrën e parë që shkoqiti deshi të hidhte baltë kundër zyrtarëve të lartë. Kijeni kujdes këtë gjarpër.* (P.Ë., I.K.:111)

- *Tiens, tiens, un certain Mark-Alem, un blanc-bec à peine entré au Tabir Sarrail a voulu en déchiffrant son premier rêve, couvrir de bout les hauts serviteurs de l'État. Tenez à l'oeil ce serpent venimeux!* (I.K.:77)

5. Era e përplaste shiun **me furi** pas xhamave dhe mazgallat e vjetra të shtëpisë rënkonin. (K.G., I.K.: 17)

- *Le vent, furieusement, envoyait battre la pluie contre les vitres et l'on entendait gémir les vieux cimbles.* (Ch.P., I.K.:11)

6. Në këtë kohë **me furtunë** le të ruajmë dashurinë për njëri-tjetrin. (I.K.:226)

- « *En cette époque tourmentée cherchons à préserver l'amour mutuel.* (I.K.:238)

7. Oh, kjo është **me të vërtetë** një punë ferri. (I.K.:115)

- *Oui le travail est vraiment infernal.* (I.K.:81)

8. **Me një fjalë**, një larje trush, mendoj. (I.K.:118)

- *Autant dire un lavage de cerveau, pensa Mark-Alem.* (I.K.:84)

9. Kur u kthye në shtëpi, babai hëngri drekë po **me atë ritëm** e qetësi që mbizotëronin në familje në të tilla raste. (L.S.: 46)

- *À son retour, mon père déjeuna donc paisiblement, dans le silence habituel, selon le rythme qui prévalait au sein de la famille lorsqu'il rentrait du travail.* (L.S.: 29)

10. Të bardha si vetë bora, **me sytë** që u shkëlqenin si shumë diej të vegjël, ato ngrohnin fëmijërinë tonë. (K.Dh., L.S.: 144)

- *Aussi blanches que la neige, elles avaient des yeux brillants comme autant de petits soleils qui réchauffaient notre enfance.* (L. Ch., L.S.: 178)

11. ...Babai u ngrit, jo pa vështirësi, dhe **me bastun në dorë**, iu afrua makinës së shkrimit... (L.B., L.S.: 264)

- *Mon père se leva non sans peine, se dirigea vers la machine à écrire en s'appuyant sur sa canne, ...* (L.P., L.S.: 294)

Duhet theksuar gjithashtu se në shumë raste parafjala *me* nuk del si një parafjalë e veçantë në përkthimin frëngjisht në disa raste të caktuara, qoftë kur tregohet mënyra se si shfaqet një veprim konkret V.(1.5), një gjendje me fjalë afektive V.(3, 7) ose me një kuptim figurativ V.(2, 4, 6) apo edhe një cilësi V.10. Sintagma në V.11. edhe **me bastun në dorë**, ku tregohet mjeti, ka mundur të përkthehet edhe me parafjalë **avec** në gjuhën frënge, si: **avec une canne à la main**, megjithatë përkthyesi e ka përkthyer me gerundif për t'i dhënë një efekt më të madh fjalisë. E njëjta gjë vërehet edhe në V.8., ku për sintagmën **me një fjalë** përkthyesi përdor shprehje tjetër (**autant dire**) kuptohet për të thënë të njëjtën gjë, po që ka mundur të përkthehet edhe me parafjalë, d.m.th. pa i ikur ortonimisë në gjuhën amtare, pra me: **en un mot**.

5. Përfundimi

Edhe pse parafjalët janë konsideruar si më pak të rëndësishme për shkak të formës së tyre, ato janë thelbësore për gjuhën sepse zënë një vend të pazëvendësueshëm. Nga gjithsej 28 shembujt e analizuar të korpusit tonë, kemi vërejtur se parafjala *me* është përkthyer me parafjalën frënge *avec* në 8 fjali, me parafjalën *de* në 5 fjali, me parafjalën *en* në 2 fjali, me parafjalën *à* në 2 fjali dhe me fjalë apo shprehje tjera në 11 fjali. Pra, përveç që i kemi hasur ekuivalentët që i përgjigjen ekuivalentëve standardë, të propozuar nga gramatika e fjalorë dygjuhësorë shqip-frëngjisht, ne kemi vërejtur edhe përkthime të ndryshme ku përkthyesi nuk e ka përkthyer tekstin burimor fjalë për fjalë, por ai ka e ka ndryshuar atë duke përdorur shprehje më të përshtatshme në gjuhën frënge.

Mund të konstatojmë se në zgjedhjen e ekuivalentëve të përshtatshëm, rol të rëndësishëm luajnë si konteksti ashtu edhe përbërja sintaksore pjesë e së cilës është parafjala e dhënë, por pa e harruar këtu edhe aspektin stilistik. Kjo nga arsyeja se ekzistojnë mundësi të shumta të përkthimit, pra është në dorën e përkthyesit të vendosë se cilën formë do ta zgjedhë. Nga kjo analizë rrjedh se edhe pse disa mënyra të përkthimit të zgjedhura nga përkthyesit për përkthimin e parafjalës *me* janë të ndryshme, megjithatë rëndësi ka se kuptimi i fjalive mbetet i njëjtë. Gjetja e ekuivalentëve të ndryshëm dëshmon për pasurinë dhe kompleksitetin e një gjuhe.

Për të përfunduar kemi zgjedhur një citim të Aristotelit: „Gjuha, sikurse edhe shkrimi dallojnë nga kultura në kulturë: por të gjitha përshtypjet mendore, të cilat përgjithësisht shprehen me simbolet e tyre përkatëse, janë identike për çdo qenie njerëzore, siç janë edhe gjërat që ata i përfaqësojnë ”. (Peri Hermenias Aristotelis)

Referencat

- [1]. Béchade, Hervé-D. (1994). *Grammaire française*, Paris: Presses Universitaires de France.
- [2]. Boissin, H. (1975). *Grammaire de l'albanais moderne*. Paris.
- [3]. Cadiot, P. (1997). *Les Prépositions abstraites en français*, Paris: Armand Colin.
- [4]. Çeliku, M. (2019). *Parafjalët e shqipes standarde (Trajtim leksiko-semantik e gramatikor)*, Tiranë.
- [5]. Iva Dedková, *La préposition avec dans un corpus littéraire contemporain*, Romanica Olomucensia 28.2 (2016): 137–151 (ISSN 1803 – 4136), pdf.
- [6]. Guillaume, G. (1971). *Leçons de linguistique*, Québec: Les Presses Universitaires de Laval.
- [7]. Injoo Choi-Jonin (La préposition “avec” : opérateur de (dé)composition), Université des Sciences Humaines Strasbourg, f. 109-129, Scolia, 5, 1995.
- [8]. Kadare, I. (2000). *Kronikë në gur*, Tiranë: Onufri.
- [9]. Kadare, I. (1973). *Chronique de la ville de pierre*, Paris: Hachette.
- [10]. Kadare, I. (1999). *Pallati i ëndrrave*, Tiranë: Onufri.
- [11]. Kadare, I. (1990). *Le Palais de rêves*, traduction Jusuf Vrioni, Paris: Fayard.
- [12]. Riegel, M. & Pellat, J.CH. & Rioul, R. (2021). *Grammaire Méthodique du Français*, Paris: Hachette.
- [13]. Starova, L. (2013). *Librat e babait*, Shkup: Libraria e Çarshisë.
- [14]. Starova, L. (1998). *Les livres de mon père*, traduction Clément d’Içartéguy, Paris: Fayard.
- [15]. Starova, L. (2013). *Koha e dhive*, Shkup: Libraria e Çarshisë.
- [16]. Starova, L. (1997). *Le temps des chèvres*, traduction Clément d’Içartéguy, Paris: Fayard.
- [17]. Xhuvani, A., *Parafjalët*, botuar në Studime Filologjike, Tiranë 1964, I.
- [18]. Xhuvani, A. Vepra I, *Parafjalët*, Tiranë, 1985.